



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:167529

Datë: 23.04.2024

Numri i dokumentit: 05607359

KPPP.nr. 1228/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Dicom Sh.p.k., me numër unik identifikues 810502444 me adresë në Bresje, Fushë Kosovë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Naim Spahiu, avokat nga Prishtina, kundër debitorit Florenti N.P.T 3 me numër fiskal 600110720 me seli në Mitrovicë, rr. Shemsi Ahmeti, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 247/2022 të datës 07.07.2022, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Mubarak S. Shumolli me zyre në Ferizaj, jashtë seancës, me datë 23.04.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit Florenti N.P.T 3, ndërsa Urdhri Përmbartimor P.nr. 247/2022 i datës 07.07.2022, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Mubarak S. Shumolli, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Dicom Sh.p.k., me datë 07.07.2022 ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.247/22 duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumenteve: faturë nr. 004314 e datës 08.01.2020; faturë nr. 000983 e datës 13.05.2020; faturë 000744 e datës 15.04.2020; faturë 000557 e datës 25.03.2020; faturë 000261 e datës 26.02.2020; duke lejuar përmbartimin në emër të borxhit në shumë prej 1330.42 EUR (njëmijë e treqind e tridhjetë euro e katër dhjetë e dy cent), me kamatëvonesë prej 8% në vit, prej datës 08.01.2020 si datë e arritshme për pagesë të faturave deri në përmblylljen e borxhit në tërësi, si dhe shpenzimet e procedurës së përmbartimit deri në pagesën definitive të borxhit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor me arsyetimin se faturat që janë objekti i propozimit për përmbarim nuk janë të përshtatshme si dokument përmbarimor sepse koha e përmbushjes është e lidhur ngushtë me barazimin e obligimeve financiare, dhe në kundërshtim me marrëveshjen e bashkëpunimit në mes të kreditorit dhe debitorit është kërkuar kompensimi i mjeteve pa barazimin e obligimeve të operatorëve ekonomik. Po ashtu ka theksuar se kreditori nuk e ka përmbushur detyrimin e tij i cili ka qenë barazimi i saldove financiare, dhe se ka dështuar të argumentoj se e ka përmbushur detyrimin e tij, që rrjedhimisht i bie se kërkesa për përmbarim është e papranueshme për shkak se nuk janë plotësuar kriteret paraprake, si dhe kjo sjellje e njëanshme dhe jo bashkëpunuese e kreditorit përbën shkelje të nenit 71 par. 1. 7 të LPP-së.

Kreditorit nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, andaj u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi për arsyet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti urdhri përmbarimor P.nr. 247/22 i datës 07.07.2022 është lejuar mbi bazën e faturës nr. 004314 e datës 08.01.2020; faturës nr. 000983 e datës 13.05.2020; faturës 000744 e datës 15.04.2020; faturës 000557 e datës 25.03.2020; faturës 000261 e datës 26.02.2020 të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në secilën faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i kësaj fature, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje, gjykata gjeti se faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara edhe në nenin 37 të LPP, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, dhe janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi dhe vula e debitorit e vënë tek pranuesi i secilës faturë.

Në anën tjetër, debitori nuk ka ofruar asnjë provë në kuptim të nenit 69.4 të LPP-së për të vërtetuar ekzistimin e një prej shkaqeve të përcaktuara me nenin 71 të LPP-së për mbështetje të prapësimit, andaj në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me refuzimin e prapësimit të debitorit, gjykata ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1228/2023, datë 23.04.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.